

## KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

**2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

**Sipas Shtojcës 9 të DST**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar).

**2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023, 2024, 2025) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlloritur të kontratës. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në Kreun V, Seksioni III, Nenin 43, pika 2/a dhe pika 3 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar). Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar (pika 1 dhe pika 2) i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitetet financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

**2.2.2** Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023, 2024, 2025) të

paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në përputhje me Ligjin Nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", (i ndryshuar).

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr.10091 date 5.3.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar" i ndryshuar.*

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, me një vlerë **jo më të vogël se 40% e vlerës** së përlllogaritur të objektit që prokurohet.

- a) *Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të e shërbimeve të realizuara.*
- b) *Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të e shërbimeve të realizuara.*

*Në rastin e procedurave të prokurimit "Shërbim konsulence", si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.*

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 55, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Duke qene se kjo procedure prokurimi do te konkludoje me nje kontrate sherbim projektimi per te deshmuar pervojen e meparshme vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të disponojë **licencë projektimi** sipas rregullores së miratuar me VKM nr. 943, datë 28/12/2016 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave

*profesionale për individë dhe persona juridikë në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrje e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”.*

**Licenca e projektimit duhet të ketë kategoritë si më poshtë:**

- 3.c1 Objekte me shkalle te larte veshtiresie beton arme
- 3.c2 Troje dhe shpate me qendrueshmeri te ulet
- 5.b Projektim furnizim me uje / kolektore shkarkimi
- 5.c Projektim ujesjelles-kanalizime
- 8.a Rivelime inxhinierike.
- 8.d Bazamente gjeodezike
- 8.e Projektim fotogrametrik dhe hartografik
- 9.e Studime e Projektme hidrogjeologjike
- 10.e Kabina elektrike te rrjetit shperndares – linja te tensionit te ulet – te mesem
- 12e- Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për trojet e shpate me qendrueshmeri te ulet dhe per troje ndertimore te shkrifeta me mundesi lengezimi.

*(Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës).*

*Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë **Liçensa profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për projektim (leshuar nga MZHUT** ose institucione të tjera të autorizuara sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e licensave profesionale në fushën e studim projektimit në ndërtim), e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mësipërme me ndryshimet përkatëse në emërtesë.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016” - lidhja 4 “kushte dhe kritere specifike që kryesisht duhen plotësuar për të fituar kategoritë në fushat e studimit dhe projektimit

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente. Kategoritë e licencës së kërkuara janë në raport

të drejtpërdrejtë me natyrën, kompleksitetin dhe komponentët teknikë të objektit të prokurimit dhe janë të nevojshme për realizimin e plotë dhe cilësor të shërbimit të studim-projektimit.

### **Kategoria 3.c1 – Objekte me shkallë të lartë vështirësie beton arme**

Kjo kategori kërkohet pasi projekti përfshin projektimin e rezervuarëve të rinj të ujit, dhomave të klorinimit, stacioneve të pompimit, puseta të komandimit dhe objekteve të tjera teknologjike prej betoni të armuar. Këto struktura kërkojnë llogaritje strukturale dhe sizmike sipas normave teknike në fuqi dhe përbëjnë elementë të rëndësishëm të sistemit të furnizimit me ujë.

### **Kategoria 3.c2 – Troje dhe shpate me qëndrueshmëri të ulët**

Kjo kategori kërkohet pasi zona ku do të zhvillohet projekti përfshin terrene kodrinore dhe pjerrësi natyrore ku do të vendosen linjat e transmetimit, rezervuarët dhe objektet ndihmëse. Projektimi kërkon vlerësim të kushteve gjeoteknike, stabilitetit të shpateve dhe përcaktimin e masave teknike për garantimin e sigurisë së veprave inxhinierike.

### **Kategoria 5.b – Projektim furnizim me ujë / kolektorë shkarkimi**

Kjo kategori është drejtpërdrejt e lidhur me objektin e kontratës, pasi projekti përfshin studimin dhe projektimin e burimeve ujore, linjave të transmetimit, sistemeve të pompimit, rezervuarëve dhe elementëve të tjerë të sistemit të furnizimit me ujë. Për këtë arsye, disponimi i kësaj pike konsiderohet i domosdoshëm.

### **Kategoria 5.c – Projektim ujësjellës-kanalizime**

Kjo kategori kërkohet pasi objekti i prokurimit konsiston në projektimin e rrjetit të furnizimit me ujë, përfshirë rrjetin shpërndarës, pusetat e kontrollit, lidhjet e abonentëve, matësat e ujit dhe të gjitha elementet përbërëse të sistemit të ujësjellësit. Kategoria garanton aftësinë profesionale për hartimin e projekteve të infrastrukturës së ujësjellësit.

### **Kategoria 8.a – Rilevime inxhinierike**

Kjo kategori kërkohet pasi hartimi i projektit kërkon kryerjen e matjeve topografike, rilevimeve të terrenit dhe përgatitjen e bazës topografike mbi të cilën do të zhvillohen studimet dhe projektimet e sistemit të furnizimit me ujë.

### **Kategoria 8.d – Bazamente gjeodezike**

Kjo kategori kërkohet për realizimin e rrjeteve gjeodezike mbështetëse të nevojshme për përcaktimin e saktë të koordinatave, kuotave dhe elementeve gjeometrike të infrastrukturës që do të projektohet, duke garantuar saktësinë e dokumentacionit teknik.

### **Kategoria 8.e – Projektim fotogrametrik dhe hartografik**

Kjo kategori kërkohet për përgatitjen dhe përpunimin e materialeve hartografike, planeve topografike dhe paraqitjeve grafike që do të përdoren gjatë studimit dhe projektimit të rrjetit të furnizimit me ujë, rezervuarëve dhe objekteve të tjera të sistemit.

### **Kategoria 9.e – Studime dhe projekte hidrogjeologjike**

Kjo kategori është thelbësore për objektin e kontratës, pasi detyra e projektimit kërkon kryerjen e studimit hidrogeologjik të të gjitha resurseve ujore të zonës, analizimin e varianteve të furnizimit me ujë, vlerësimin e kapaciteteve ujëmbajtëse të burimeve dhe përcaktimin e zgjidhjes optimale për furnizimin e fshatrave Suhë dhe Stegopull.

#### **Kategoria 10.e – Kabina elektrike të rrjetit shpërndarës, linja të tensionit të ulët dhe të mesëm**

Kjo kategori kërkohet pasi projekti përfshin rehabilitimin ose ndërtimin e stacioneve të pompimit dhe sistemeve të furnizimit me energji elektrike të tyre. Për funksionimin e sistemeve të pompimit nevojitet projektim i instalimeve elektrike, kabinave, komandimit dhe mbrojtjes elektrike sipas standardeve teknike në fuqi.

#### **Kategoria 12.e – Studime/Vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për troje dhe shpate me qëndrueshmëri të ulët dhe për troje ndërtimore të shkrifëta me mundësi lëngëzimi**

Kjo kategori kërkohet pasi projekti përfshin ndërtimin e objekteve inxhinierike si rezervuarë, stacione pompimi dhe struktura të tjera teknologjike, për të cilat është e nevojshme vlerësimi i kushteve sizmike dhe gjeoteknike të truallit. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në rastet kur objektet vendosen në terrene me pjerrësi, me karakteristika gjeologjike të veçanta ose me potencial për paqëndrueshmëri gjatë veprimit sizmik.

**2.3.3** Një punësim mesatar i të paktën **12 (dymbëdhjetë) personave**, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore minimumi për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.
- b. Listpagesat e punonjesve të konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi minimumi për 3 muajt e fundit të deklaruar.

*Shënim: Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST.*

**Argumentimi:** Këto kërkesa për stafin janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma ”c” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri për fuqinë punetore është bërë në përputhje me realizimin e suksesshëm të shërbimit për objektin.

Objekti i kontratës “Studim - Projektim për ndërtimin e rrjetit të furnizimit me ujë të fshatrave Suhë dhe Stegopull, Bashkia Libohovë”, përfshin realizimin e studimeve topografike, gjeologjike, hidrogeologjike, analizave laboratorike të burimeve ujore, studimin e zonave sanitare, hartimin e varianteve të furnizimit me ujë, projektimin e linjave të transmetimit, rezervuarëve, stacioneve të pompimit, rrjeteve shpërndarëse, instalimeve elektrike, përgatitjen e preventivave, specifikimeve teknike dhe dokumentacionit të plotë të zbatimit.

Për shkak të natyrës multidisiplinore të kontratës dhe afatit të shkurtër të realizimit prej **2 (dy) muajsh**, kërkohet që një pjesë e konsiderueshme e aktiviteteve të kryhen paralelisht, duke angazhuar specialistë të fushave të ndryshme si hidroteknikë, hidrogjeologë, gjeologë, topografë, inxhinierë ndërtimi, inxhinierë elektrikë, specialistë GIS dhe personel teknik mbështetës.

Gjithashtu, gjatë periudhës së realizimit do të kryhen njëkohësisht punime në terren për matje topografike dhe verifikime teknike, studime hidrogjeologjike dhe gjeologjike, përpunim i të dhënave, hartim i varianteve teknike dhe projektim i komponentëve të sistemit të furnizimit me ujë, çka kërkon një strukturë organizative të konsoliduar dhe burime njerëzore të mjaftueshme.

Për këtë arsye, është kërkuar që operatori ekonomik të disponojë një numër mesatar prej jo më pak se **12 (dymbëdhjetë) punonjësish** të deklaruar gjatë 3 muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave. Ky numër konsiderohet proporcional me natyrën, kompleksitetin, vlerën dhe afatin e realizimit të kontratës dhe garanton disponueshmërinë e burimeve njerëzore të nevojshme për përmbushjen e kontratës brenda afateve të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor.

Kërkesa është vendosur në respektim të parimit të proporcionalitetit dhe synon të garantojë që operatori ekonomik disponon kapacitetet minimale organizative dhe profesionale të nevojshme për realizimin me sukses të shërbimit objekt prokurimi.

**2.3.4** Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për ekzekutimin e objektit të prokurimit, të përfshirë në licencën e shoqërisë si drejtues teknik, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, CV ku të kenë të paktën 10 vite eksperiencë, diplomë dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

- 1 (nje) Inxhinier Ndertimi
- 1 (nje) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (nje) Inxhinier Gjeodet
- 1 (nje) Inxhinier Gjeoteknik/Gjeolog
- 1 (nje) Inxhinier Elektrik
- 1 (një) Inxhinier Mekanik
- 1 (një) Inxhinier Mjedisi
- 1 (një) Inxhinier Sizmiolog/Gjeofizik/Hidrogjeolog
- 1 (një) Arkitekt

Drejtuesit teknik si më sipër duhet të jenë të punësuar pranë shoqërisë dhe të përmbushin kriteret sipas parashikimeve të vendimit nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016”.

- *Arkitekti nuk kërkohet të jetë domosdoshmerisht i përfshirë si drejtues teknik në licencën e shoqërisë. Ai mund të disponohet nga operatori ekonomik si pjesë e ekipit të projektimit*

**ose specialist i ekipit të projektimit, i vërtetuar me diplomë, CV profesionale dhe kontratë pune ose kontratë angazhimi të vlefshme për periudhën e realizimit të kontratës.**

*Shënim: Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST.*

*Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit.*

**Argumentimi:** Spas Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar Neni 77 Kërkesat për kualifikim, pika 4 Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Stafi i mesiperm, do të realizojë projektet sipas kompetences dhe licences bazuar në VKM nr.759, datë 12.11.2014 “Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

<b>KATEGORIA E KËRKUAR</b>	<b>PERSHKRIMI PER KATEGORITE</b>
Inxhinier Ndërtimi	Bazuar në termat e referencës, Inxhinieri i Ndërtimit kërkohet për projektimin strukturor të rezervuarëve të ujit, dhomave të klorinimit, stacioneve të pompimit, pusetave dhe objekteve të tjera ndihmëse që do të parashikohen në kuadër të sistemit të furnizimit me ujë. Gjithashtu ai do të kryejë llogaritjet statike dhe sizmike të strukturave të betonarmeve sipas standardeve dhe normave teknike në fuqi.
Inxhinier Hidroteknik	Bazuar në termat e referencës, Inxhinieri Hidroteknik është specialisti kryesor i projektit dhe kërkohet për studimin dhe projektimin e sistemit të furnizimit me ujë, përfshirë veprat e marrjes së ujit, linjat e transmetimit, stacionet e pompimit, rezervuarët, rrjetin shpërndarës, pusetat teknologjike dhe kryerjen e llogaritjeve hidraulike të sistemit.
Inxhinier Gjeodet	Bazuar në termat e referencës, Inxhinieri Gjeodet kërkohet për realizimin e rëlevimeve topografike, përcaktimin e koordinatave dhe kuotave të terrenit, hartimin e planeve topografike, piktimin e objekteve dhe përgatitjen e bazës topografike të nevojshme për zhvillimin e projektit të zbatimit.
Inxhinier Gjeoteknik/Gjeolog	Bazuar në termat e referencës, Inxhinieri Gjeoteknik/Gjeolog kërkohet për studimin e karakteristikave gjeologjike dhe gjeoteknike të zonës, vlerësimin e stabilitetit të terrenit, përcaktimin e parametrave të truallit dhe rekomandimin e zgjidhjeve teknike për ndërtimin e rezervuarëve,

	stacioneve të pompimit dhe veprave të tjera inxhinierike.
Inxhinier Elektrik	Bazuar në termat e referencës, Inxhinieri Elektrik kërkohet për projektimin e furnizimit me energji elektrike të stacioneve të pompimit, sistemeve të komandimit dhe kontrollit, kabinave elektrike, instalimeve të fuqisë dhe ndriçimit, si dhe të sistemeve të mbrojtjes elektrike të objekteve që do të projektohen.
Inxhinier Mekanik	Bazuar në termat e referencës, Inxhinieri Mekanik kërkohet për projektimin e pajisjeve mekanike të sistemit, përfshirë pompat, kolektorët, armaturat, valvulat, sistemet e klorinimit dhe elementët e tjerë mekanikë që do të integrohen në funksionimin e sistemit të furnizimit me ujë.
Inxhinier Mjedisi	Bazuar në termat e referencës, Inxhinieri i Mjedisit kërkohet për hartimin e dokumentacionit mjedisor, vlerësimin e ndikimit në mjedis, identifikimin e masave mbrojtëse gjatë zbatimit të projektit dhe vlerësimin e ndikimeve të mundshme mbi burimet ujore dhe mjedisin përreth.
Inxhinier Sizmiolog/Gjeofizik/Hidrogjeolog	Bazuar në termat e referencës, Inxhinieri Hidrogjeolog kërkohet për realizimin e studimit hidrogjeologjik të burimeve ujore, vlerësimin e potencialit ujëmbajtës të tyre, analizimin e varianteve të furnizimit me ujë, përcaktimin e zonave sanitare të mbrojtjes, si dhe për hartimin e raportit hidrogjeologjik dhe opionencës përkatëse.
Arkitekt	Bazuar në termat e referencës, Arkitekti kërkohet për projektimin arkitektonik dhe funksional të objekteve teknologjike që do të ndërtohen në kuadër të sistemit të furnizimit me ujë, si rezervuarët, dhomat e klorinimit, stacionet e pompimit dhe objektet ndihmëse, duke siguruar integrimin e tyre me terrenin, mjedisin përreth dhe kërkesat funksionale të projektit.

**2.3.5** Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë staf mbështetës për realizimin e këtij shërbimi punonjësit e mëposhtëm të cilet duhet të jenë të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

- **1 (një)** punonjës me çertifikatë "**Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë**" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr.10237 datë 18/02/2010 "Përsigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr.312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Përsigurinë në kantier", shoqëruar me kontratën individuale të punës të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.( Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike,grupimi duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 një punonjës me çertifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë")
- **1 (një)** punonjës i pajisur me çertifikatë "**Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave**" e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq ose shoqëri të akredituara ose nga ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, Për këtë duhet të paraqitet certifikata e tranimit si ekspert për dhenien e ndihmes së parë dhe ndërhyrjes ndaj emergjencave" e dhënë nga një organizem i licencuar,shqiptar ose i huaj, kontrata e punës, si dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. (Në rastin e bashkimit të operatoreve

ekonomike, grupimi duhet te kete pjese te stafit te tij 1 nje punonjës " Ekspert për ndihmën e pare dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”)

*Shënim: Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST.*

*Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“ , te ndryshuar , me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë nje liste personeli kryesor të nevojshme për te zbatuar objektin e prokurimit dhe /ose komponentet e saj, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Njesia e prokurimit per vendosjen e stafit ndihmës i eshte referuar Termave References .

### **Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë**

Objekti i kontratës përfshin kryerjen e aktiviteteve në terren, si rlevime topografike, inspektime të burimeve ujore, verifikime të gjurmëve të linjave të transmetimit, studime gjeologjike dhe hidrogjeologjike, si dhe aktivitete të tjera që zhvillohen në terrene me karakteristika të ndryshme morfologjike dhe gjeologjike.

Për garantimin e sigurisë së personelit të angazhuar gjatë kryerjes së këtyre aktiviteteve në terren dhe për zbatimin e masave të parandalimit të rreziqeve profesionale, kërkohet disponimi i një punonjësi të certifikuar si “Përgjegjës për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë”, i cili do të mbikëqyrë respektimin e rregullave të sigurisë gjatë realizimit të shërbimeve objekt prokurimi.

### **Ekspert për ndihmën e pare dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave**

Kjo kërkesë është vendosur duke marrë në konsideratë natyrën e shërbimeve që do të realizohen në kuadër të kontratës, të cilat përfshijnë aktivitete të shumta në terren, si rlevime topografike, inspektime të burimeve ujore, studime gjeologjike dhe hidrogjeologjike, si dhe verifikime teknike në zona me terren të vështirë dhe larg qendrave të banuara.

Prania e një punonjësi të trajnuar për dhënien e ndihmës së parë dhe ndërhyrjen në raste emergjente synon të garantojë reagimin e menjëhershëm në rast aksidentesh, dëmtimesh ose situatash të paparashikuara që mund të ndodhin gjatë aktiviteteve në terren, deri në mbërritjen e shërbimeve të specializuara mjekësore.

#### **2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:**

- a) Certifikatën e cilësisë së punimeve **ISO 9001-2015** (e vlefshme)/ose/ekuivalent **Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë**.
- b) Certifikatën e cilësisë së punimeve **ISO 14001-2015** (e vlefshme)/ose/ekuivalent **Për sistemin e menaxhimit cilesise se Mjedisit**.
- c) Certifikatën e cilësisë së punimeve **ISO 45001-2018** (e vlefshme)/ose/ekuivalent **Për sistemin e Menaxhimit të Shendetit dhe Sigurise ne Pune**.

Shënim: Në rastet e Bashkimit te Operatoreve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqese certifikatën e mësipërme në bazë të zërave të marrë përsipër të realizoje sipas marrëveshjes së bashkëpunimit.

**Argumentim:** Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 2.3.6 gërma “a”- “c” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 79, pika 1 ku citohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”*, si dhe ne zbatim te Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”*.

**ISO 9001:2015** është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, qe i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me **ISO 9001:2015** me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta. Certifikimi ISO 9001:2015 garanton që operatori ekonomik zbaton procedura të standardizuara për menaxhimin e cilësisë dhe kontrollin e proceseve të projektimit.

**ISO 14001:2015** ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me **ISO 14001:2015** me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit. Ky certifikim garanton që operatori ekonomik disponon procedura dhe sisteme të menaxhimit mjedisor në përputhje me standartet ndërkombëtare.

**ISO 45001-2018** është standard ndërkombëtare, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo ofertues duhet të jetë i pajisur me **ISO 45001-2018** me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tije (në rastin konkret realizimi objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi. Ky certifikim garanton që operatori ekonomik disponon një sistem të menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në punë në përputhje me standardet ndërkombëtare.

**2.3.7** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim mbi disponueshmërinë e mjeteve që do shërbejnë për ofrimin e shërbimit të projektimit, ku të përcaktohen të dhënat teknike dhe sasitë përkatëse për mjetet e mëposhtme:

- 1 (nje) pajisje GPS (për matje gjeodezike dhe koordinata)
- 1 (nje) total station (për rievime topografike me saktësi)
- 1 (një) pajisje Droni. (për ortofoto, verifikime në terren, modelim të terrenit dhe identifikim të gjurmës së linjave)

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, duhet të paraqitet dokumentacioni i vlefshëm, si më poshtë: dokumentacion për pajisjen në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

*Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit si pas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertues i kualifikuar i pari, për para publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë pajisje, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Pajisjet e kërkuara janë vendosur në proporcion me realizimin e shërbimit.

Objekti i kontratës përfshin kryerjen e studimeve topografike, hidrogeologjike dhe projektimin e sistemit të furnizimit me. Për realizimin e saktë të këtyre shërbimeve kërkohet disponimi i pajisjeve të specializuara për matje, rievim dhe verifikim në terren.

Pajisja GPS kërkohet për përcaktimin e koordinatave dhe elementeve gjeodezike të objekteve që do të projektohen.

Pajisja Total Station kërkohet për kryerjen e rievimeve topografike dhe përgatitjen e planimeve të nevojshme për projektimin.

Pajisja Dron kërkohet për evidentimin e gjendjes ekzistuese të terrenit, identifikimin e gjurmëve të linjave të transmetimit, dokumentimin fotografik dhe mbledhjen e të dhënave hapësinore që do të përdoren gjatë hartimit të projektit.

Këto pajisje konsiderohen të nevojshme dhe proporcionale me natyrën e shërbimit të kërkuar dhe garantojnë realizimin e studimeve dhe projektimit sipas standardeve teknike dhe kërkesave të përcaktuara në termat e referencës.

**2.3.8** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një CV të shoqërisë për punët e realizuara gjatë aktivitetit të saj.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë eksperience të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.*

Kjo kërkesë është vendosur me qëllim njohjen e profilit profesional, përvojës së përgjithshme dhe kapaciteteve organizative të operatorit ekonomik që do të angazhohet në realizimin e kontratës.

CV-ja e shoqërisë shërben si dokument informues për Autoritetin Kontraktor dhe mundëson një paraqitje të përmbledhur të aktivitetit, eksperiencës dhe kapaciteteve profesionale të operatorit ekonomik në fushën e studimit dhe projektimit.

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose të kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Operatori ekonomik ofertues në përlllogaritjen e ofertës duhet të referohet njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik "Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim".

Mospërgatitja e ofertës sipas bazës ligjore të sipërpërmendur përbën shkak për skualifikim pasi ajo duhet të jetë brenda kufijve të vlerës minimale dhe maksimale të lejuar në kuptim të nenit 7/1 të VKM nr 354, datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim" i azhurnuar.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**